



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.1052/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Zyhdi Haziri kryesues, Rustem Thaqi dhe Adnan Konoshevcu anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e Reshat Selimi kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Suharekës, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Suharekës, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.1052/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga Reshat Selimi kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Suharekës, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Suharekës, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, me të cilën ka kërkuar rinumërim të votave në Vendvotimet 2404A/01R, 2428A/01, 2403A/01R, 2403A/02R, 2403A/03R, 2403A/04R, 2403A/05R.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.1052/2021 të paraqitur nga Reshat Selimi kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Suharekës, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Suharekës, me të cilën pretendon se në vendvotimet 2404A/01R, 2428A/01, 2403A/01R, 2403A/02R, 2403A/03R, 2403A/04R, 2403A/05R, ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave. Apelit i ka bashkangjitur deklarata të dëshmitarëve votues.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga Reshat Selimi kandidat për Kuvend Komunal në Komunën e Suharekës, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Suharekës, me të cilën kërkon rinumërim të votave në vendvotimet e lartcekura, është i pa bazuar. Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje

të pretendimeve të tije, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur sepse i nijeti për të gjitha vendvotimet e pretenduara në apel që figurojnë nga rezultatet përfundimtare të shpallura nga KQZ, rezulton se apeluesi ka më shumë vota në këto vendvotime se sa dëshmi që i ka bashkangjitur si dëshmitar. Edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e apeluesit nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkret por janë vetëm pretendime të supozuara dhe se këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme.

Paneli i vlerësoi edhe pretendimet lidhur me votat e pa vlefshme në qendrat e votimit të cekura më lartë, por erdhi në përfundim se këto pretendime janë të pa bazuara. Për rastin konkret apeluesi nuk ka bashkangjitur asnjë provë qoftë ndonjë formular apo dëshmi tjetër që do të vërtetonte pretendimet e tij, se ka pas ndërhyrje në vota

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.1052/2021 më datën 07.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.